



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Buxhet dhe financa
Zyra e tatimit në pronë

NJOFTIM
Vazhdohet afati për faljen e borxheve të tatimit në pronë

09.02.2017

Komuna e Vushtrrisë njofton të gjithë qytetarët se vazhdohet afati për faljen e borxheve deri më **01.09.2017**. Falja e borxheve bëhet për obligimet e pashlyera të qytetarëve ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike të krijuara deri më 31 dhjetor 2008.

Kushtet për falje të borxheve janë:

- Të kryhen pagesat e plota të obligimeve për periudhën nga 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014. Më këtë rast do të përfitojnë edhe me faljen e gjobave, ndëshkimeve, interesit dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e borxhit bazë për periudhën 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014
- Të lidhen marrëveshje me Institucionin Shtetëror apo Ndërmarrjen Publike për pagesën e borxheve me këste për periudhën 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014. Në rastin kur arrihet marrëveshjet, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe faljen e ndëshkimeve për periudhën 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014. Për borxhet e pashlyera deri më 31 dhjetor 2008, ku shuma totale e borxhit bazë është në vlera të vogla prej një (1) deri njëqind euro (100), këto borxhe do të fshihen me automatizëm. Për informata më të hollësishme në lidhje me faljen e borxheve mund të drejtoheni në Komunën e Vushtrrisë, Zyrën e Tatimit në Pronë.